

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës **Dhënie me koncesion te hidrocentralit “Grabovë 2”**

Forma e kontratës **B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)**

Burimi i financimit Shoqëri tregtare private / Kapital privat

Vlera e parashikuar e projektit: 1,486,571,351 Leke (pa TVSH)

Kohëzgjatja e kontratës : 35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 20 date 22.5.2017

Njoftojmë se, kane qene pjesëmarrës ne procedure këta ofertues me ofertën përkatëse te

ofruara: **Buletini Nr. 31 datë 07 Gusht 2017 Agjencia e Prokurimit Publik Bulevardi**

“Deshmoret e Kombit”, Keshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 301/325

1. Bashkimi i Përkohshëm te Shoqërive “Vëllezërit Hysa” sh.p.k. dhe “Hydropower” sh.p.k.,

- Fuqia e instaluar e përcaktuar me prurjen llogaritëse 8,100 kW

Prodhimi i energjisë elektrike 35,414,438 kWh

- Vlera e “Fee koncesionare” 2.1% (743,703 kWh)
- Koha e zbatimit te punimeve 24 muaj
- Kosto për njësi e makinerive dhe

Pajisjeve për kW fuqi te instaluar 75,000 leke/kW

Vlera e investimit (pa TVSH) 1,486,571,351 Leke

* * *

Ministria e Energjisë dhe Industrisë lajmëron **Z. Kujtim Hysa**, Administratorin e shoqërisë “Vëllezërit Hysa” sh.p.k., Përfaqësues i Bashkimit te Përkohshëm “Vëllezërit Hysa” sh.p.k. dhe “Hydropower” sh.p.k. me adrese: Bulevardi Qemal Stafa, Hotel “Skampa”, Kati I, Elbasan, se oferta e paraqitur më datë 20 Qershor 2017, për marrjen me koncesion te hidrocentralit “Grabovë 2”, është pranuar.

Afati i negociimit te Kontratës tuaj do te jete brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit te fituesit.

Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive “Vëllezërit Hysa” sh.p.k. dhe “Hydropower” sh.p.k. kërkohet t’i paraqesë Ministrisë se Energjisë dhe Industrisë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve te Përgjithshme dhe te Veçanta te Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës se kërkuar ne Dokumentat Standarte te Procedurës Konkurruese, ne vlerën e 10% te Investimit (pa TVSH). Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nënshkrimit te Kontratës nga te dy palët.
- Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokure) duhet te nënshkruajnë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë

ofertën ekonomike. Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim te rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP. Ne rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet te njoftoni me shkrim.